

VENDIM
Nr.443, datë 3.6.2020

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, MIRATUAR NË
BUXHETIN E VITIT 2020, PËR FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT TË
BANESAVE INDIVIDUALE DHE NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA
(PALLAT), NË BASHKINË SHIJAK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 25 dhe 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitin 2020, për financimin e rikonstruksionit të banesave individuale dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat) për ata individë të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, në Bashkinë Shijak.

2. Përdorimi i fondit, sipas pikës 1, të këtij vendimi, është në masën 512 967 289 (pesëqind e dymbëdhjetë milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë dhe i shtohet Bashkisë Shijak, në buxhetin e miratuar për vitin 2020, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Shijak për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama